

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

## PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

SESIONI II

(I DETYRUAR)

VARIANTI **A**

E premte, 9 shtator 2011

Ora 10.00

**Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe**

**Gjimnazi: Drejtimi shoqëror dhe i përgjithshëm**

### Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në prozë dhe në dramë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dyja pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

### Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7a	7b	8	9	10a	10b	10c
Pikët													
Kërkesa	11	12a	12b	12c	12d	13	14	15	16	17	18	19	20a
Pikët													
Kërkesa	20b	21A	21B	22	23	24A	24B	25a	25b	25c	25d		
Pikët													

Totali i pikëve

### KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

**PJESA I****FAIK KONICA****SHQIPËRIA - KOPSHTI SHKËMBOR I EVROPËS  
JUGLINDORE (fragment)**

...Në një vend tjetër koloneli Lik bën këto vërejtje: “Ndryshe nga turku dembel e fodull ose nga fshatari grek i varfër, që ka humbur gjallërinë si pasojë e mjerimit dhe shtypjes së vazhdueshme, këta shqiptarët janë të dalluar për veprimtarinë e tyre të palodhur. Çdo pikë mbizotëruese pranë rrugës kam parë se e kanë zënë një ose disa prej tyre, në kohën që më dilte para syve dhe dukej se bënë një garë se kush do të arrinte më parë. Gjithë pyetjeve për topografinë ata i përgjigjen me përpikëri dhe me zgjuarsiri të madhe, ndërsa shpërblimi më i mirë për ta është leja që u jap të shohin goniometrin tim. Nuk ka gjëra më të ndryshme nga njëra-tjetra sesa sjellja e shqiptarëve dhe sjellja e osmanëve, që janë qeniet njerëzore më dembele e flegmatike, me përjashtim të çastit kur i lëviz nga vendi ndonjë nxitje e jashtëzakonshme”.

Hobhauzit, mikut të Bajronit e që u quajt më pas lord Brauton, i kishte bërë shumë përshtypje ndjenja kombëtare, si një tipar i shqiptarëve. “Këtu ka, - thotë ai, - një shpirt pavarësie dhe dashuri për atdheun nga gjithë populli e kjo në një masë të madhe e mënjanon dallimin e thellë që vihet re në pjesët e tjera të Turqisë, ndërmjet pasuesve të dy feve. Kështu, kur banorët e viseve të tjera i pyet se çfarë janë, ata përgjigjen: “Jemi turq” ose “Jemi të krishterë”, ndërsa banori i këtij vendi përgjigjet “Jam shqiptar”... Ndjenja kombëtare bie fort në sy në karakterin e tyre. Nëse ndonjë prej tyre largohet nga vendi dhe duke rrugëtuar merr vesh se një bashkatdhetar banon në një fshat pranë të cilit mund të kalojë, ndonëse nuk e ka parë e as nuk ka dëgjuar ndonjëherë për të, ai ndërton rrugë dhe shkon për ta takuar. Disa herë kam qenë dëshmitar i gëzimit që ata shprehin kur takohen kështu, rastësisht dhe e shfaqin më haptas sesa i tregojnë ndjenjat dy anglezë miq në këto raste. E gjithë mënyra e sjelljes së tyre është e përzemërt dhe kur, pas një mungese të shkurtër, ndodh që një shqiptar ndesh një të njohur, i jep dorën e djathtë dhe e puth në faqe dhe po kështu bëjnë kur ndahen, ndërsa po të jenë takuar në rrugë, kur largohen ca njëri nga tjetri, qëllojnë me pistoletë ose me pushkë.”

Po kështu një autor francez i shekullit të nëntëmbëdhjetë, admirali Zhyrjen de Gravjerë, i cili, si komandant i flotës franceze në Mesdheun Lindor për shumë vjet, u kishte bërë një studim të thelluar shqiptarëve, ka vënë në dukje se “kombësia i bashkon shqiptarët shumë më tepër se feja”.

Vëzhgimet e Hobhauzit për frymën kombëtare janë me interes të veçantë për studiuesin, sepse ndërmjet viteve 1878 dhe 1920 serbët dhe grekët, këta “humoristë të pavetëdijshëm”, vazhdimisht janë përpjekur që, kundër formimit të një shteti shqiptar të shfrytëzojnë argumentin se nuk ekziston kombi shqiptar. Fuqitë e Mëdha kanë qeshur me ta, madje një diplomat bëri një pyetje, pa i mëshuar fort, se a ka një gjë të tillë që quhet kombësia greke, të dalluar nga kisha greke?

Hobhauzi vë re se shqiptarët “nuk janë me shpirt të keq dhe, kur bëhen të pamëshirshëm, kjo nuk vjen nga parimi i hakmarrjes sesa nga pasioni i çastit. Tradhtia është një ves që zor se e gjen ndërmjet tyre”. Por vëzhgimet më të mira në studimin e thelluar të Hobhauzit janë për dëshirën e shqiptarëve për argëtim.

“Kënaqësia e tij më e madhe, - shkruan Hobhauzi, - kur nuk është i zënë me luftë, është të ngrohet në diell, të pijë duhan, të hajë, të pijë raki, të dremisë ose të vijë rrotull në kopshtin rreth kasolles së vet, duke i rënë lahutës me një melodi të vetme. Ndonëse është i ngeshëm, përsëri ai është i padurueshëm dhe i gatshëm të rrëmbejë pushkën e të fshihet në pyll me thirrjen e parë të prijësit të vet.

Për pyetjet nga 1 deri në 6 rrethoni alternativën e saktë.

1. Kjo vepër konsiderohet si: **1 pikë**
- A) kronikë historie.  
B) shkrim historik.  
C) histori e letrarizuar.  
D) trajtesë me natyrë historike e psikosociale.
2. Studimet e Konicës në këtë vepër vijnë të paplota në esetë që lidhen me: **1 pikë**
- A) letërsinë  
B) historinë  
C) gjeografinë  
D) jetën zakonore
3. Karakteri i pamëshirshëm i shqiptarit, sipas Hobhauzit, përcaktohet nga: **1 pikë**
- A) natyra fodulle.  
B) pasioni i çastit.  
C) parimi i hakmarrjes.  
D) urrejtja gjenetike.
4. Sipas përcaktimit të bërë nga koloneli Lik, shqiptarët janë: **1 pikë**
- A) veprimtarë të palodhur.  
B) fshatarë të varfër.  
C) fodullë të paditur.  
D) të mençur, por dembelë.
5. Kur Konica thotë *Ndryshe nga turku dembel e fodull*, fjala fodull ka kuptimin: **1 pikë**
- A) inatçor  
B) indiferent  
C) hipokrit  
D) mendjemadh
6. Zbuloni cila nga fjalitë e mëposhtme ka strukturën sintaksore të një fjalie të përbërë me lidhje bashkërenditëse: **1 pikë**
- A) *Ndryshe nga turku dembel e fodull ose nga fshatari grek i varfër, që ka humbur gjallërinë si pasojë e mjerimit dhe shtypjes së vazhdueshme, këta shqiptarët janë të dalluar për veprimtarinë e tyre të palodhur.*  
B) *Fuqitë e Mëdha kanë qeshur me to, madje një diplomat bëri një pyetje, pa i mëshuar fort, se a ka një gjë të tillë që quhet kombësia greke, të dalluar nga kisha greke?*  
C) *Gjithë pyetjeve për topografinë ata i përgjigjen me përpikëri dhe me zgjuarsiri të madhe, ndërsa shpërblimi më i mirë për ta është leja për të parë goniometrin tim.*  
D) *Kënaqësia e tij më e madhe është të ngrohet në diell, të pijë duhan, të hajë, të pijë raki, të dremisë ose të vijë rrotull në kopshtin rreth kasolles së vet, duke i rënë lahutës me një melodi të vetme*
7. Zbuloni dy nga argumentet që sjell Konica në mbështetje të ndjenjës së fortë kombëtare të shqiptarëve.
- a) \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- b) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

8. Shpjegoni si ndryshon Konica nga bashkëkohësit e tij në trajtimin e kësaj ndjenje. **2 pikë**

---



---

9. Ky fragment karakterizohet nga një frymë polemizuese. Cili është thelbi i kësaj polemike dhe kundër kujt drejtohet ajo? **2 pikë**

---



---

10. Identifikoni tri karakteristika të shqiptarëve, që Konica i thekson përmes vëzhgimeve që kanë sjellë të huajt për ta.

a) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

b) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

c) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

11. Në ç'vetë është shkruar kjo vepër? Sipas mendimit tuaj, pse rrëfimi është në këtë vetë?

**2 pikë**

---



---

12. Ky shkrim është një ese studimore. Identifikoni tri arsye që e bëjnë atë të tillë. Njëren nga arsyet ilustroni me shembull nga fragmenti.

a) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

b) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

c) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

d) Ilustrimi: **1 pikë**

---



---

**PJESA II****ESKILI****KOEFORET***Eriniet (episodi III)***KORIFEJA**

Ç'gjëmë e zezë obobo! Ç'krim që shpirtin  
trishton!  
Prej një vdekje të tmerrshme, mbretëreshë, ti re.  
Kujë, kujë e më keq! Sa shumë që vonon,  
Aq m'i egër ndëshkimi shpërthen ogurzi. (...)

**ORESTI**

Triumfin dhe mynxyrën bashkë i ndjej.  
Gëzohem dhe rënkoj dhe krimin dhe ndëshkimin  
Për gjithë fisin tim ku rëndon nëma,  
Dhe për fitoren që përzishëm ndrit.

**KORIFEJA**

S'ka të vdekshëm në botë që rrugën e tij  
Pa një faj ta kalojë, pa dhimbje e dënim.  
Një mënxyrë kalon  
Tjetra pret pak më tej.

**ORESTI**

Por, dijeni: unë s'di ku do mbaroj;  
Si rendësin, që kuajt i kanë ikur  
Prej frerëve, ashtu mendje e shfrenuar  
Dhe mua më heq zvarrë, ndërsa një Tmerr  
Të parrëfyer kam këtu në gjoks,  
Që hidhet, ia merr këngës, ulërin  
Me zemrën time tok. Dëgjomëni, pra,  
Unë po thërres: e vrava nënën time  
Me plot të drejtë ngaqë vrau tim atë!  
Prej hyjve vrasja miratuar qe,  
Vetë zoti Apolon më dha guximin  
Se krim ky s'do quhej, por përkundrazi  
Të bëj atë që bëra duke thënë  
Në qoftë se nuk e bëj do kem torturë  
Të tillë q'asnjë shigjetë përmes saj  
Duke vrapuar fundin dot s'ia gjen.  
Tani më shihni, ja po nisem shpejt  
Me një kurorë ulliri arratisem  
Drejt tempullit të Febit, te kërthiza  
E botës, ku nuk shuhet kurrë zjarri,  
Atje, nga gjaku i nënës të shpëtoj.  
Kurse nga ju, më vonë, banorë të Argosit,  
S'kërkoj veç të dëshmoni të vërtetën  
Për vrasjet që u bënë te ky pallat;  
Ndërsa për mua s'ka veç tmerr e ikje,  
Si i mallkuar i dheut të shtegtoj  
Me emrin vrasës në gjallje e në mort.

**KORIFEJA**

Ti triumfove. Pse nga goja nxjerr  
Të tilla fjalë? Vetën mos mallko,  
Në ditën kur dy koka gjarpërinjsh  
I preve dhe lirinë solle për ne.  
(*Oresti që bëhet gati të niset, sprapset i tmerruar*)

**ORESTI**

Ah, ah ç'po shoh atje... ca gra, fantazma  
Veshur në zi, me flokë gjarpërinjsh...  
T'iki me vrap!

**KORIFEJA**

Ç'hije të kota, vallë, të turbullojnë,  
Ty, bir i shtrenjtë i mbretit tonë hero?  
Kurajë, një fitues si ti nuk trembet!

**ORESTI**

Jo, s'janë hije të kota...Nëna ime  
Q'andej qentë e hakmarrjes më ka çuar.

**KORIFEJA**

Mbi duar ende gjaku s'të është' tharë,  
Ndaj të ka zënë e shpirtin ta trazon.

**ORESTI**

Zot Apolon, si mizëri po shtohen,  
Nga sytë gjak i zi pikë-pikë kullon.  
Ju nuk i shihni, veçse unë i shoh:  
Më ndjekin pas. Po shkoj nga sytë këmbët!  
(*Del me vrap si i çakërdisur*)

**KORIFEJA**

Pra lamtumirë! Ndonjë hyj të ndjektë,  
Të ruajt, për ditë më të mira.

*Për pyetjet nga 13 deri në 19 rrethoni alternativën e saktë.*

- 13.** Eskili, për të shkruar këtë tragjedi, u mbështet në: **1 pikë**
- A) balada të vjetra.
  - B) eposin homerik.
  - C) një histori të vërtetë.
  - D) mitin e Atridëve.
- 14.** Tragjedia ka në qendër të saj heronj: **1 pikë**
- A) historikë
  - B) mitikë
  - C) realë
  - D) të jashtëzakonshëm
- 15.** Në këtë skenë Orestit shfaqet: **1 pikë**
- A) energjik
  - B) i dëshpëruar
  - C) triumfator
  - D) i matur
- 16.** Në këtë episod Korifeja e këshillon Orestin: **1 pikë**
- A) të strehohet në tempullin e Febit.
  - B) të mos ndeshet me Eriniët se do të humbasë.
  - C) të përballet si burrë me Eriniët.
  - D) të ruajë arsyen dhe të jetë i guximshëm.
- 17.** Cili grup fjalësh është njësi frazeologjike? **1 pikë**
- A) Po shkoj nga sytë këmbët!
  - B) Si i mallkuar i dheut të shtegtoj.
  - C) Ndërsa për mua s'ka veç tmerr e ikje.
  - D) Me emrin vrasës në gjallje e në mort.
- 18.** Në vargun: *Për gjithë fisin tim ku rëndon nëma*, fjala “nëma” do të thotë: **1 pikë**
- A) gjëmë
  - B) mallkim
  - C) dënim
  - D) profeci
- 19.** Në cilën prej alternativave të mëposhtme është përdorur epitete metaforik? **1 pikë**
- A) Ç'krim që shpirtin trishton
  - B) Për gjithë fisin tim ku rëndon nëma
  - C) Si i mallkuar i dheut të shtegtoj
  - D) Veshur në zi, me flokë gjarpërinjsh.

20. Gjeni një nga motivet kryesore të tragjedisë në këtë pjesë. Ilustrojeni atë me vargjet përkatëse.

a) Motivi: \_\_\_\_\_ **1 pikë**

b) Ilustrimi: \_\_\_\_\_ **1 pikë**

\_\_\_\_\_

21.

A) Analizoni gjendjen psikologjike të Orestit (vargjet 5-8) përmes, të paktën, dy figurave të stilistikës. **2 pikë**

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

B) Identifikoni dy argumentet që sjell Oresti për të justifikuar aktin e kryer. **2 pikë**

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

22. Ç' nënkuptojnë dy detajet e nënvizuara në vargjet e mëposhtme? **2 pikë**

Me një kurorë ulliri arratisem

Drejt tempullit të Febit, te kërthiza

E botës, ku nuk shuhet kurrë zjarri,

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

23. Çfarë ideje do të nënvizojë Eskili në vargjet e mëposhtme? **1 pikë**

*Si i mallkuar i dheut të shtegtoj*

*Me emrin vrasës në gjallje e në mort.*

\_\_\_\_\_

24.

A) Ç' simbolizojnë *eriniet*? Si i përshkruan Oresti ato? Si e shpjegoni faktin se vetëm ai mund t'i shohë? **3 pikë**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

B) Si e konsideron Oresti vrasjen e nënës: si “detyrë” apo si veprim që e dëshironte edhe vetë ta kryente? Pse? **2 pikë**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

